



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca Plenare  
Seanca nr.2003/10  
Prishtinë, më 3 prill 2003, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Nexhat DACI**, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse bashkëkryesues ishte **Bajram Kosumi**.  
Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 103 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit i seancës së mëparshme;
2. Debati për ekspozenë e kryeministrit për punën njëvjeçare të Qeverisë;
3. Shqyrtimi i veprimeve të mëtejme për zbatimin e Ligjit për arsimin e lartë;
4. Shqyrtimi i propozimit për miratimin e nismës për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional;
5. Shqyrtimi i dytë I P/ligjit për Bibliotekat-2003/4;
6. Shqyrtimi i propozimit për emrimin e anëtarve të Komisionit për media;
7. Shqyrtimi i propozimit të Grupi parlamentar të komuniteteve tjera (joshqiptare dhe joserbe) për emrimin dhe zëvendësimin e anëtarve të komisioneve parlamentare;
8. Përcaktimi i rendit të ditës për seancën plenare që duhet të mbahet më 10 prill 2003;
9. Parashtrimi i pyetjeve.

**1. Miratimi i procesverbalit i seancës së mëparshme.**

Nuk pati vërejtje në procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

## 2. Debatimi për ekspozitën e kryeministrit për punën njëvjeçare të Qeverisë.

**Kryesuesi** hapi debatin parlamentar lidhur me ekspozitën e kryeministrit për punën njëvjeçare të Qeverisë.

**Sabri Hamiti** tha se e përkrah punën njëvjeçare të Qeverisë që e kemi formuar bashkarisht me një marrëveshje politike dhe kemi përjashtuar mundësinë e krijimit të një opozite të saj. Kjo nënkupton që përgjegjësitë për të mirën ose të keqen e ndajmë bashkarisht dhe synimet e mëtutjeshme duhet ti ndajmë bashkë. Institucionet tona duhet të forcohen, të funksionalizohen, të profesionalizohen dhe të bëhen më të përgjegjshme.

Ai apeloj për një unitet brenda Qeverisë, përkatësisht ministrive që të kenë strukturimin dhe harmonizimin e nevojshëm që të jenë në gjendje të marrin përgjegjësitë dhe kompetencat për realizimin e kërkesave të qytetarëve. Dhe në emër të këtij harmonizimi, shtoi z. Hamiti se në të gjitha pikat e veta Qeveria duhet të bërë një përmirësim funksional dhe profesional.

Në fund z. Hamiti pyeti se a i zbaton Qeveria e Kosovës në përpikëri ligjet që i miraton Kuvendi i Kosovës? Ai apeloj tek të gjitha partitë politike që ta përkrahin Qeverinë e Kosovës për zbatimin e ligjeve që i miraton Kuvendi i Kosovës.

**Hashim Thaqi** tha se pas zgjedhjeve të suksesshme pasoi një vit i angazhimeve dhe përpjekjeve të përbashkëta për realizimin e prioritetëve që dalin nga marrëveshja e tri partive politike shqiptare.

Nga niveli i konkurrencës normale politike kaluam në partneritet qeverisës, për të mirën e vendit dhe të qytetarëve. Sot në Qeveri participojnë me sukses edhe të gjitha grupimet politike minoritare. Kosova ka edhe opozitë, propozimet dhe kritikën e së cilës kanë qenë me qëllim të mirë që duhet t'i respektojë Qeveria e Kosovës. Andaj, konstatoi z. Thaqi se Kosova ka një Qeveri stabile, transparente në punë, shumë partiake dhe shumë etnike.

Në Kosovë, sot si kurrë më parë respektohen të drejtat e njeriut, ato gjinore, fetare, politike, shprehja e lirë e mendimit, mbi të gjitha të drejtat e minoritarëve, theksoi z. Thaqi.

Në planin e zhvillimit ekonomik janë arritur rezultate solide. Privatizimi është në fazën e parë të realizimit të tij. Ky proces duhet të jetë i suksesshëm dhe do të hapen shumë biznese të vogla dhe ndërmarrje prodhimi. Qeveria e Kosovës duhet të shtoi përkujdesin më tepër për pensionistët, të papunët, për familjet e dëshmorëve, fëmijët jetim, për invalidët e luftës dhe të kategorive tjera sociale.

Qeveria duhet të vazhdoi debatin me UNMIK-un, që të drejtat e rezervuara të barten gradualisht tek institucionet vendore. Kosova ka nevojë për politikë të jashtme, për qasje të drejtpërdrejtë në organet e gjyqësisë dhe të drejtësisë dhe për përgjegjësitë në fushën e sigurisë. Duhet ti iket ndikimit të politikës partiake në Qeveri, Ministri dhe në institucionet tjera duhet të ketë më tepër profesionalizëm theksoi z. Thaqi.

**Dragisha Krstoviq** tha se ekspozitën sipas teorisë juridike dhe ekonomike duhet të jetë një raport i Qeverisë që i paraqet Parlamentit. Ekspozitën e kryeministrit ka pasur tjetër efekt dhe tjetër qëllim. Në ekspozitë është përdorur terminologjia mbi shtetin e pavarur të Kosovës; ekonomia e vendit; vendi fqinjë, Serbia. Në ekspozitë janë thënë shumë të pa vërteta lidhur me anëtarët e bashkësisë nacionale serbe, posaqërisht kur flitet për klimën e sigurisë në Kosovë, me të cilën koalicioni "Kthimi" nuk pajtohet.

Në ekspozite flitet për punën e disa ministrive në krye të cilave gjenden shqiptarët, kurse për atë të Shëndetësisë dhe të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka asnjë të dhënë. Andaj, kz ekspozite për koalicionin "Kthimi" është i papranueshëm, theksoi Krstoviq.

**Bajram Kosumi** tha se Grupi parlamentar i AAK-së, e përkrah punën njëvjeçare të Qeverisë së Kosovës. Qeveria nuk ka mundur të ketë efikasitet më të madh në këtë pozitë kushtetuese çfarë është. Prandaj, të gjithë ne duhet të angazhohemi për krijimin e një kualiteti të ri kushtetues dhe institucional në Kosovë.

Gjendja e tanishme në Kosovë është në stagnim të përgjithshëm. Madje, në disa fusha ka edhe degradim, siç është rasti në KEK, PTK, Dogana etj. Prandaj, Qeveria duhet bërë përcaktimin e orientimeve të reja, si vijon: a). Në hartimin e p/ligjeve të reja; b). Qeveria prioritet në hartimin e p/ligjeve duhet ti jep ligjeve nga fusha ekonomike që përkrahin prodhimin dhe afarizmin vendor; c). Kompetencat që janë të definuara në Kornizën Kushtetuese duhet ti barten Qeverisë dhe institucioneve tjera, kurse për kompetencat e rezervuara të PSSP-së duhet të formohet një grup punues që të bisedoi me PSSP-në, për bartjen e tyre siç janë: Ministria e Rendit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria për Integritet Euroatlantike, theksoi z. Kosumi. Për çështjen e statusit final të Kosovës, Qeveria duhet të mbështetet në platformën që duhet ta miratoi Kuvendi i Kosovës.

**Faik Marolli** tha se Grupi i komuniteteve tjera e përkrah ekspozitën e kryeministrit për punën njëvjeçare të Qeverisë.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta lidhur me ekspozitën e kryeministrit për punën njëvjeçare të Qeverisë i dhanë edhe këta deputetë: **Gojko Saviq, Sylejman Çerkezi, Hasan Meta, Muhamet Kelmendi, Mahir Yagcilar, Xhevdet Neziraj, Fatmir Rexhepi, Teuta Hadri, Smilka Milisavleviq, Haki Shatri, Mevlyde Saraqi, Sabile Basha, Alush Gashi, Bajrush Xhemaili, Rangjel Nojkiq, Ramadan Kelmendi, Sadik Idriz, Drita Statovci, Naim Maloku, Fadil Kryeziu, Sadullah Hoxha, Fetije Këpuska, Xhezair Murati, Bogoljub Millosheviq, Tomë Hajdaraj, Sabri Fejzullahu, Nurishahe Hulaj dhe Gani Koci, që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Në fund kryeministri **Bajram Rexhepi**, iu përgjigj pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve që u janë bashkangjitur transkriptit.

### 3. Shqyrtimi i veprimeve të mëtejme për zbatimin e Ligjit për Arsimin e Lartë.

Kryesuesi tha se janë bërë shumë përpjekje që të tejkalohen vështirësit për shpalljen dhe zbatimin e këtij ligji, por ato kanë qenë të pasuksesshme. Në ndërkohë është menjanuar vërejtja kryesore e UNMIK-ut në atë ligj, ngase tani funksionojnë të gjitha fakultetet në gjuhën serbe në Mitrovicë, të pakontrolluara as nga UNMIK-u, as nga Qeveria. Por, në të njëjtën kohë pas nëntë muajve, arsimit superior në Universitetin e Prishtinës, në gjuhën shqipe ka ardhur në pozitë të shkatërrimit.

Kryesuesi tha se në një shkresë që i ka dërguar PSSP-së, ka kërkuar në mënyrë decisive

që ndërhyrjet e UNMIK-ut në fushën legislative mund të jenë gjatë fazës përgatitore, duke bashkëpunuar me zyrën ligjore të Qeverisë dhe komisionet e Kuvendit. Pas miratimit të ligjeve në Kuvend, është vetëm një mundësi, kur ligji në praktikë has në ndonjë pengesë në zbatimin e ndonjë neni, atëherë fillon procedura e re për ndryshimin e atij neni. Me këtë qëndrim është pajtuar edhe z. Shtajner, theksoi kryesuesi.

**Kryesuesi** i propozoi Kuvendit, si vijon:

Në mbështetje të kreut 9.1.26, të Kornizës Kushtetuese lidhur me përgjegjësitë, Kuvendi për miratimin e ligjeve dhe rezolutave si dhe përgjegjësitë e tjera të parapara me Kornizë Kushtetuese dhe me instrumente të tjera ligjore, duke ritheksuar se Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv dhe zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi, brenda fushës së përgjegjësisë të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, kreu 9.3.1 i Kornizës Kushtetuese duke konstatuar se UNMIK-u, pa mbështetje ligjore bënë zbatimin selektiv të dispozitave dhe neneve të ligjit për arsimin e lartë në Kosovë 2002/3, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 25 korrik 2002, në seancën plenare të mbajtur me 3 prill 2003, miratoi këtë:

### Q Ë N D R I M

Institucionet e përkohshme të qeverisjes në Kosovë, Qeveria në kuadër të saj, Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji si dhe Universiteti, të gjitha aktivitetet që dalin nga përgjegjësitë e tyre lidhur me institucionet e shkollimit të lartë, duhet ti zbatojnë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë 2002/3, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 25 korrik 2002.

**Kryesuesi** vuri në votim këtë propozim dhe rezultati ishte si vijon:

Për ----- shumica  
Kundër -----11  
Abstenime-----6

Vazhdim i seancës plenare me 4 prill 2003.

Seancën e kryesoi **Bajram Kosumi**, kurse bashkëkryesuese ishte **Nafiye Gash**. Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 89 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

#### 4. Shqyrtimi i propozimit për miratimin e nismës për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna, Park Nacional

**Xhavit Haliti** tha se akti i djeshëm i shpalljes së qëndrimit të Kuvendit lidhur me zbatimin e Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë, pa e pasur paraprakisht tekstin e propozuar askush nga deputetët, është bërë në kundërshtim me procedurën e Kuvendit. Dhe ky veprim na ka futur në një konflikt të ri me UNMIK-un, ngase ai pas një ore të miratimit të qëndrimit në Kuvend, e ka zhvlerësuar atë. Ai pyeti se çka duhet bërë Kuvendi që ky Ligj të zbatohet?

**Sabri Hamiti** tha se ai ka qenë një qëndrim i imponuar nga mosfuqia e zbatimit të Ligjit për Arsimin e Lartë, i cili unanimisht është miratuar dhe është e padobishme, që sot të hapet debat lidhur me të.

**Kryesuesi** e ftoi ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, që ta arsyetonte propozimin për miratimin e nismës për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna, Park Nacional.

**Ministri Et'hem Çeku** tha se parqet nacionale çdokund në botë janë vlerat e trashëgimisë natyrore që paraqesin pasuritë identifikuese të një vendi. Nisma për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna, Park Nacional ka filluar që nga vitet e '80-ta.

Studimin e parë për arsyeshmërinë e saj e ka bërë Enti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës me 1985. Vlerat natyrore të Bjeshkëve të Nemuna sipas atij studimi janë vlerësuar të larta dhe që i kalojnë kufijtë e Kosovës dhe të rajonit si qendër e biodiversitetit.

Konceptet e reja në botë për parqe nacionale janë ato që nuk paraqesin hapësira të mbyllura në emër të mbrojtjes së natyrës, por që ato të jenë në shërbim të zhvillimit të përgjithshëm për qytetarët që jetojnë në atë zonë, përmes zhvillimit të turizmit dhe formave tjera, theksoi ministri Çeku.

Për bazën mbrojtëse të kësaj zone janë propozuar të mbrohen rreth 4.227 hektar, afërsisht 10% e sipërfaqës së propozuar duke përfshirë: Grykën e Rugovës, Drinin e Bardhë etj. Andaj, i propozoi Kuvendit të Kosovës që të miratojnë nismën për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna, Park Nacional.

**Arsim Bajrami** tha se parshtron mocion për shkeljen e procedurës me rastin e miratimit të qëndrimit të Kuvendit lidhur me Ligjin për arsimin e lartë .

PDK-ja e përkrah nismën për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional dhe kërkon nga Ministria e ambientit dhe planifikimit hapsinor, që të përgatis listën e viseve tjera që meritojnë të shpallen parqe nacionale.

**Naim Maloku** tha se Komisioni parlamentar për mjedis dhe planifikim hapsinor e përkrah këtë nismë. Komisioni ka biseduar me përgjegjësit e komunës së Deçanit, të cilët kanë shprehur rezervë lidhur me kufijtë e Parkut Nacional që do të përfshihen me këtë propozim. Duhet të konsultohen ata, para se të propozohet P/ligji në Kuvend, në mënyrë që të mos ketë mosmarrëveshje për këtë çështje.

Kontestuese sipas Komisionit, shtoi z. Maloku, është emërtimi i Bjeshkëve të Nemuna. A duhet të quhen ato "Alpet Shqiptare" apo "Alpet e Ballkanit", duhet të konsultohen ekspertët e kësaj fushe. Shpallja e këtij parku, Park Nacional do të ndikoj në bashkëpunimin e Kosovës me vendet fqinje, sidomos Malin e Zi dhe Shqipërinë, theksoi z. Maloku.

**Tomë Hajdaraj** tha se Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e përkrah këtë nismë. Komisioni e ka shqyrtuar këtë nismë dhe ka bërë sugjerimet e veta lidhur me të. Në propozim nuk përmenden saktësisht karakteristikat e përgjithshme të zonës e cila është e mbuluar me pyje të larta e që paraqet resurs kryesor të lëndës së parë për industrinë pyjore dhe të prodhimit të drurit. Duhet pasur parasysh se një pjesë e kësaj sipërfaqe është në sektorin privat dhe me rastin e miratimit të kësaj nisme, atyre duhet kompenzuar vlerën e pronës. Njëri

prej problemeve serioze për industrinë e përpunimit të drurit është mungesa e lëndës së parë të saj dhe një planifikim i gabueshëm e dëmton seriozisht atë.  
Komisioni sugjeron që të formohet një grup punues nga ekspertët e kësaj fushe si dhe pronarët e pronave private që do të merren me këtë problematikë. Duhet të bëhet ndarja e zonave dhe rajoneve duke marrë parasysh faktorët siç janë: ekosistemi, vlerat për rekreacion, nevoja për ruajtjen e karakteristikave specifike natyrore, që ruhen përmes intervenimit dhe menaxhimit të rajonit për ruajtjen e peisazheve, theksoi z. Hajdaraj.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta lidhur me nismën për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional i dhanë edhe këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Shefki Sejdiu, Bogoljub Millosheviq, Mark Krasniqi, Hasan Meta, Blerim Baruti, Nimon Alimusaj, Xhavit Haliti dhe Bujar Dugolli, që u janë bashkangjitur transkriptit.**

**Kryesuesi** e vuri në votim këtë propozim dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----43  
Kundër-----5  
Abstenime-----5

**Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi nismën për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional.**

#### **5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Bibliotekat**

Kryesuesi i vuri në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Buxhet, Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, Komisionit për Kulturë, Rini dhe Sport, Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Grupit parlamentar "Kthimi", të deputetës Exhlale Salihu dhe të deputetit Lirak Qelaj.

**Kuvendi i miratoi këto amendamente:**

1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12, 14, 16, 17, 21, 22, 24, 26, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 43, 47, 48, 50, 53, 54, 56, 57, 59, 60, 61, 64, 67, 68, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 79, 80, 81, 82, 83, 85, 87, 88, 92, 93, 94, 95, 96, 99 dhe 100.

**Kurse i refuzoi këto amendamente:**

8, 13, 15, 18, 19, 20, 23, 25, 27, 28, 29, 37a, 38, 42, 44, 45, 46, 49, 51, 52, 55, 58, 62, 63, 65, 66, 69, 78, 84, 86, 89, 90, 91, 97 dhe 98.

**Kryesuesi** e vuri në votim P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për -----shumica  
Kundër-----6  
Abstenime-----0

**Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për Biblotekat.**

**6. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Media.**

**Kryesuesi e vuri në votim propozimin e anëtarëve të Komisionit për Media në këtë përbërje:**

1. Kryesuesi - Bogoljub Millosheviq – KK
2. Zv.kryesuesi i parë – Sabit Rrustemi – LDK
3. Zv.kryesuesi i dytë – Hajredin Kuqi – PDK
4. Anëtari 1 - Nimon Alimusaj – LDK
5. Anëtari 2 - Alush Gashi - LDK
6. Anëtari 3 - Kolë Berisha - LDK
7. Anëtari 4 - Gjylshen Berisha – LDK
8. Anëtari 5 - Hydajet Hyseni - PDK
9. Anëtari 6 - Vesna Jovanoviq – KK
10. Anëtari 10 - Zylfi Merxha - KT
11. Anëtari 11 - Bujar Dugolli - AAK

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për -----50  
Kundër-----7  
Abstenime-----3

**Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi propozimin e Komisionit për Media.**

**7. Shqyrtimi i propozimit të Grupit parlamentar të komuniteteve tjera (joshqiptare dhe joserbe) për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.**

**Kryesuesi e vuri në shqyrtim propozimin e Grupit parlamentar të komuniteteve tjera që kishin propozuar që të emërojnë dhe zëvendësojnë për vendet në komisione të Kuvendit me këta anëtarë:**

1. Sadik Idriz nga “Vatan” anëtar i Komisionit për Personat e Humbur dhe të Kidnapuar.
2. Zehra Elezi nga “Vatan” anëtare e Komisionit për Barazi Gjinore.
3. Zylfi Merxha nga “KT” anëtar i Komisionit për Media
4. Nafiye Gash nga “KDTP” kryetare e Komisionit për Shëndetësi në vend të Sabit Rrahmanit nga ish- PDASHK dhe
5. Sadik Idriz nga “Vatan” anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në vend të Zehra Elezit.

**Sabri Hamiti** pyeti se a ka të drejtë që anëtarja e Kryesisë znj. Nafije Gash të jetë kryetare e një komisioni parlamentar?

**Xhezair Murati** tha se e ka propozuar znj. Nafije Gash anëtare e Kryesisë për kryetare të Komisionit për shëndetësi me qëllim të ruajtjes së baraspeshës nacionale. Por, nuk e ka shqyrtuar pengesat juridike lidhur me të dhe propozoi që propozimi për znj. N. Gash, të shtyhet për senacën e ardhshme plenare.

**Kryesuesi** e vuri në votim propozimin e Grupit parlamentar të komuniteteve tjera, përveç znj. Nafije Gash dhe rezultati ishte si vijon:

Për----- shumica

Kunër-----1

Abstenime-----2

**Kryesuesi** konstatoi: Kuvendi miratoi propozimin e Grupit parlamentar të komuniteteve tjera lidhur me emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

#### 8. Parashtrimi i pyetjeve.

**Deputeti Ismajl Kurteshi** i kishte parashtruar pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me emërimin e drejtorëve në shkolla.

**Ministri Rexhep Osmani** iu përgjigj pyetjes së parashtruar të deputetit Ismajl Kurteshit , që i është bashkangjitur transkriptit.

**Ismajl Kurteshi** tha se nuk është i kënaqur me përgjigjen e ministrit Osmani, duke pasur parasysh mënyrën e emërimit të drejtorëve në shkollat e komunës së Gjilanit.

#### 9. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare që duhet të mbahet me 10 prill 2003.

**Kryesuesi** propozoi këtë **rend dite**:

1. Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës
2. Shqyrtimi i P/ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për kooperativat bujqësore
4. Shqyrtimi i Raportit për personat e humbur dhe të kidnapuar.

Kuvendi e miratoi rendin e ditës për seancën e ardhshme plenare.

**Sekretaria e Kuvendit**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**

**akademik Nexhat DACI**